



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 14648/1 prot.

Vlorë, më 01.10 2024

VENDIM

Nr. 91, Datë, 26.09 2024

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “VLORA PARKING” SH.A SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VLORE DHE MIRATIMIN E STATUTIT”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9/1, pika 1/b dhe 7/a, neni 54, pika m, ne Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligji nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), neni 35 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);

V E N D O S I:

1. Krijimin e shoqërisë me emërtimin tregtar “VLORA PARKING” sh.a, shoqëri aksionere, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë nga Bashkia Vlorë me objekt veprimtarie:
 - Menaxhimin e shërbimit të parkimit publik në qytet.
2. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri sh.a, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
3. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “VLORA PARKING” sh.a, të jetë 3.500.000 lekë.

4. Bashkia Vlorë është ortaku i vetëm themelues, i cili zotëron 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë “VLORA PARKING” sh.a. të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 3.500.000 lekë.
5. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a, fillimisht të ketë selinë qendrore pranë Bashkisë Vlorë.
6. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a. të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.
7. Pas miratimit të kërkesës për themelimin e shoqërisë aksionare themeluesi cakton Administratorin/Administratorët për herë të parë.
8. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 3.500.000 lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2024.
9. Bashkia Vlorë, Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe Kontabilitetit angazhohet në mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit.
10. Bashkia Vlorë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “VLORA PARKING”, sh.a. në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
11. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësojë Bashkinë Vlorë, në cilësinë e aksionarit të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
12. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Ky Projekt - Vendim hyn në fuqi menjëherë sipas Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

**ME URDHËR DELEGIMI
NËNKRYETAR**

Myzafer Elezi

